



Datë:02.06.2025

NumërProtokolli:3745/2025

A.nr.672/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.264/2025, të datës 17.04.2025, të parashtruar nga ankuesi F.M., kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.672/2025, e datës 17.04.2025, e parashtruar nga ankuesi F.M.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, F.M. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 16.04.2025, ka parashtruar ankesë në e-mailin zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net, e cila ankesë është regjistruar me datë 17.04.2025 dhe protokolluar me numër 2526/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 31.03.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.04.2024 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo i fundit, me datë 08.05.2024, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 14.02.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00016731, për pozitën e punës “Zyrtar i Regjistrimit Civil”, në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil në Viti, me afat aplikimi nga 15.05.2025 deri më datë 16.03.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo sipas Njoftimit të datës 31.03.2025, Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, rezulton se ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk posedon diplomën e arsimit të nivelit të lartë, e nivelit të parë (Bachelor) .

Andaj, kundër Njoftimit të datës 31.03.2025, lidhur me refuzimin e aplikacionit, ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet se i njëjti ka përfunduar Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës, dhe ka mbrojtur temën e diplomën me notën nëntë (9), më datë 23.08.1999, siç dëshmohet edhe me certifikatën e lëshuar nga fakulteti, andaj i njëjti kërkon që aplikimi i tij të konsiderohet i vlefshëm dhe ti mundësohet pjesëmarrja tutje në procedurën e rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 17.04.2024, kundër Njoftimit të datës 31.03.2025 mbi refuzimin e aplikacionit, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka parashtruar ankesë ende pa përfunduar procedura e rekrutimit me numër reference RN00016731, e shpallur me datë 14.02.2025, për pozitën për pozitën e punës “Zyrtar i Regjistrimit Civil”, në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil në Viti.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 17.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.672/2025, të datës 17.04.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të rekrutimit nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për refuzimin e aplikacionit të tij.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.672/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.M.;
- Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.